



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY



Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

OSHP: 2023/0301

Paneli Shqyrtues, i emëruar nga Kryetarja e Organit Shqyrtues të Prokurimit Publik (OSHP), në bazë të nenit 105,106 dhe 117 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës (Ligji Nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092), në përbërje nga: Vedat Poterqoi panelist individual, duke vendosur sipas ankesës së parashtruar nga OE “Matkos Pharm” sh.p.k., me seli në Prishtinë, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Furnizim me preparate stomatologjike për DSHB ” me nr. të prokurimit: 206-23-2009-1-2-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK)-Ministria e Shëndetësisë, me datën 20.06.2023, mori këtë:

Vendim

1. Aprovohet, si e bazuar ankesa e OE “Matkos Pharm” sh.p.k., me nr. 2023/0301, e datës 23/05/2023, kurse vendimi i AK Ministria e Shëndetësisë lidhur me aktivitetin e prokurimit Furnizim me Preparate Stomatologjike për DSHB me numër të prokurimit 206-23-2009-1-2-1 anulohet, ndërkaq aktiviteti i prokurimit kthehet në Rivlerësim.
2. Në afat prej 10 ditësh, AK duhet ta informojë OSHP për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit, në të kundërtën, OSHP ka të drejtë të ndërmarrë masa ndaj AK për mos respektim të vendimit sikurse parashihet me dispozitat e nenit 131 të LPP.
3. Kthehen mjetet e deponuara në emër të taksës tarifore për parashtrimin e ankesës në llogarinë e Operatorit Ekonomik “Matkos Pharm” sh.p.k.

Arsyetim

- Faktet dhe rrethanat procedurale –

Me 15.03.2023, Ministria e Shëndetësisë në cilësinë e Autoritetit Kontraktues ka publikuar B58 Njoftimin për Kontratë për aktivitetit të prokurimit me titull: “Furnizim me preparate stomatologjike për DSHB ” me nr. të prokurimit: 206-23-2009-1-2-1, Me datën 05.04.2023 është bërë hapja e tenderit dhe me datën 15.05.2023 AK ka publikuar B58-Njoftimin mbi vendimin e AK-Lista standarde ku është rekomanduar për kontratë OE “Koslabor H ” sh.p.k.

Me datë 18.05.2023, OE ankues “Matkos Pharm” nga Prishtina ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim pran AK- Ministria e Shëndetësisë, me datë 22.05.2023 AK e ka refuzuar kërkesën për rishqyrtim dhe e ka vërtetuar vendimin e Autoritetit Kontraktues të datës 15.05.2023.

Me datën 23.05.2023 OE ankues “Matkos Pharm” nga Prishtina, ka parashtruar ankesë në OSHP-ë, me numër të protokollit 301/2023, kundër B58 Njoftimit mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues të aktivitetit të prokurimit të përshkruar si më sipër.

Autoriteti kontraktues ka zbatuar procedurë të hapur, lloji i kontratës: blerje, vlera e parashikuar e kontratës: 45,000 €.

Ankesa e OE është ushtruar në pajtim me nenin 109.1, të LPP, sipas të cilit kundër çdo vendimi të marrë nga AK çdo palë e interesuar mund të parashtrorë ankesë pranë OSHP. Meqë OE ka ushtruar po ashtu kërkesë për rishqyrtim, do të thotë se veprimet e të njëjtit i referohen po ashtu dhe nenit 108/A të Ligjit të cituar. Prandaj OSHP konsideron se Ankesa i plotëson kushtet e parapara në kuptim të dispozitave tani më të cituara dhe e njëjta bie nën kompetencat e tij në kuptim të nenit 105, të LPP.

Organi Shqyrtues i Prokurimit i ka njoftuar palët me datë: 29 Maj 2023 me raportin e ekspertizës. AK Ministria e Shëndetësisë është deklaruar se nuk pajtohet me mendimin e ekspertit shqyrtues, ndërsa OE ankuese “Matkos Pharm” nga Prishtina nuk ka deklaruar se a pajtohet apo nuk pajtohet me mendimin e ekspertit shqyrtues.

- Vlerësimi dhe administrimi i provave –

Bazuar në veprimet e përshkruara si më sipër, OSHP ka angazhuar ekspertin vlerësues në pajtim me nenin 111, paragrafi 5 të LPP, me detyrë që i njëjti në kuptim të nenit 113 të Ligjit të cituar, ta bëjë shqyrtimin fillestar të dosjes dhe pretendimeve ankimore, përkitazi me aktivitetin e prokurimit të përshkruar si më sipër. Lidhur me këtë, me 29.05.2023, eksperti shqyrtues ka dorëzuar Raportin e vlerësimit me rekomandimet si në vijim:

- ankesa e OE ankues “Matkos Pharm” sh.p.k nga Prishtina të aprovohet, si e bazuar.

- të anulohet B58 Njoftimi mbi Vendimin e AK-së të datës 15.05.2023, ndërkaq lënda të kthehet në rivlerësim me qëllim të trajtimit të barabartë të OE-ve dhe të kërkohen informata shtesë në pajtim me dispozitat e nenit 72 të LPP-së

Përgjigje në pretendimet ankimore të OE ankues “Matkos Pharm” sh.p.k

Eksperti shqyrtues, pas ekzaminimit të dosjes së tenderit, shqyrtimit të rrjedhës së procedurës së tenderimit dhe pretendimeve të palës në ankesë sqaron me sa vijon:

Përgjigje në pretendimi nr.1

Lidhur me pretendimin ne këtë aktivitet te prokurimit te operatorit ekonomik ankues, se me datën 05.04.2023 është bërë hapja e tenderit, ku ne si OE kemi qenë me çmim më të lirë, ndërsa kërkesa për dokumente shtesë është bërë me datën 26.04.2023 për të na shpall fitues.

Pas kësaj procedure AK shpall vendimin me datën 15.05.2023 duke na eliminuar ne si OE, me arsyetimin e vendimit të OSHP-së te datës 08.05.2023, vendim ky i cili përcakton saktë periudhën e ndalesës nga 02.05.2023 deri 01.05.2024. Andaj ne deri me këtë date nuk kemi pasur asnjë ndalesë sa i përket pjesëmarrjes ne prokurim publik.

Ky tender ne fjalë është një muaj para vendimit te OSHP-së, dhe rrjedhimisht nuk mund te ketë fuqi retroaktive, në të kundërtën i bie qe ndalesa do ishte ne kohëzgjatje me shume se 1 vit dhe kështu është ne kundërshtim me ligjin e LPP-së nenin 99.

Eksperti shqyrtues sqaron, se duke u bazuar ne analizën e fakteve/dëshmime të dokumentuara ne platformën elektronike e-prokurim, rrjedhën dhe analizën procedurës se prokurimit, vendimin mbi refuzimin e kërkesës për rishqyrtim lidhur me këtë aktivitet të prokurimit, AK me datën 13.03.2023 publikon njoftimin për kontratë lidhur për këtë aktivitet te prokurimit, ndërsa hapja është bërë me date 05.04.2023, kurse komisioni i vlerësimit me date 10.05.2023 nënshkruan raportin e vlerësimit, dhe AK me date 15.05.2023 publikon B58 Njoftimin mbi vendimin e AK dhe letraret standarde për tenderuesin e eliminuar.

Gjithashtu, Eksperti shqyrtues sqaron, se duke u bazuar ne analizën e fakteve/dëshmime të dokumentuara ne platformën elektronike e-prokurim, rrjedhën dhe analizën procedurës se prokurimit, bazuar ne opinionin e dhënë nga KRPP ne pyetjen nr.8 te datës 22.11.2022, ndër te tjera jap sqarim si ne vijim:

“Operatori Ekonomik në çdo rast përjashtohet nga pjesëmarrja në procedurat e prokurimit prej momentit kur ka ndodhë deklarata e rreme. Pra, prej momentit kur konstatohet rrethana e sanksionuar dhe meqenëse dispozita e lart cekur nuk përcakton asgjë, përjashtimi duhet të vlejë për aktivitetet e prokurimit të publikuara brenda periudhës së përcaktuar me këtë nen. Përjashtimi nuk duhet të vlejë për aktivitetet e prokurimit që janë në proces (të publikuara para datës së vendimit për përjashtim), për dy arsye: a) sanksioni duhet të vlejë vetëm për aktivitetet e prokurimit të publikuara brenda një viti nga data e vendimit, përndryshe sanksioni do të kthehej në fakt para kohës kur ka ndodhë rrethana e sanksionuar; dhe b) Nëse përjashtimi do të zbatohet edhe për aktivitetet e prokurimit që janë në proces, efekti i tij i vërtetë sanksionues do të ishte për një periudhë më shumë se një vit, gjë që do të binte ndesh me ligjin”. Prandaj, duke u bazuar ne këto fakte dhe duke pas parasysh kërkesën e AK te lartpërmendur dhe analizës se mësipërme vlerësojë se pretendimi i palës në ankese në këtë pikë është i qëndrueshëm.

Eksperti shqyrtues sqaron, se duke u bazuar ne analizën e fakteve/dëshmime të dokumentuara ne platformën elektronike e-prokurim, rrjedhën dhe analizën procedurës se prokurimit, AK – komisioni i vlerësimit, nuk ka respektuar nenin 7, 59 dhe 60 të LPP-së, andaj, Është përgjegjësi, dhe në diskrecion të Autoritetit Kontraktues, respektivisht komisionit të vlerësimit – ZPP, që

procesi i vlerësimit, ekzaminimit dhe krahasimit të behet ne harmoni te plote me dispozitat ligjore te LPP-se, ne këtë aktivitet te prokurimit, ne mënyrë qe të respektohen kërkesat e përzgjedhjes, specififikimet teknike Aneksi 1 ne dosje te tenderit si dhe te respektohen kriteret e dhënies.

Eksperti shqyrtues sqaron, se autoritetet kontraktues janë te obliguara që të sigurojnë që fondet publike dhe burimet publike te përdoren në mënyrën më ekonomike, njëkohësisht duke marr në konsideratë qëllimin dhe lëndën e prokurimit, ashtu siç parashihet në nenin 6 të LPP-së, autoriteti kontraktues duhet te këtë ne konsideratë edhe nenin 1 të LPP-së, pasi që dihet se qëllimi i këtij ligji është te siguroj mënyrën më efikas, më transparent dhe më të drejt të shfrytëzimit të fondeve dhe burimeve publike.

REKOMANDIMI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Duke u bazuar në faktet, sqarimet e lartpërmendura dhe te gjeturat tjera ne këtë raport, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të aprovohet si e bazuar, (për arsyen që u cek tek përgjigja në pretendimet si më lartë) dhe rekomandon që të anulohet B58-njoftimit mbi vendimin AK (vendimit për dhënie të kontratës) dhe lënda të kthehet në Rivlerësim.

Paneli Shqyrtues konsideroi se lidhur me çështjen në rastin konkret, nuk ka nevojë të konvokohet seanca dëgjimore me palë, konform nenit 24 paragrafi 1, i Rregullores së Punës së OSHP, përderisa pretendimet e palëve, provat, parashtrësat e tyre dhe ekspertiza e ekspertit shqyrtues, ofrojnë të dhëna të mjaftueshme për të vendosur në aspektin meritior.

Paneli shqyrtues pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, shqyrtimit të pretendimeve ankimore të OE ankues, konstatimeve, analizës konkrete dhe rekomandimeve të ekspertit shqyrtues, deklarimit të palëve në procedurë, diskutimeve dhe administrimit të provave në tërësi, e të gjithë aktivitetit të prokurimit të lartë shënuar, konsideron se gjetjet e ekspertit shqyrtues dhe mendimi i tij janë të pranueshme nga ana e këtij paneli dhe si rrjedhojë paneli vendosi që ankesa OE ankues të aprovohet si e bazuar anulohet vendimi i AK i datës 15.05.2023, dhe aktiviteti i prokurimit të sipër shënuar, konform mendimit të ekspertit shqyrtues dhe interpretimit të KRPP, lënda të kthehet në rivlerësim.

Paneli Shqyrtues kërkon nga AK që të njëjtit të jenë të vëmendshëm gjatë procedurave të prokurimit publik në të ardhmen duke respektuar në përpikëri Ligjin e Prokurimit Publik dhe rregullat e zbatueshme, dhe po ashtu urdhëron të njëjtit të veprojnë në harmoni me rekomandimet e dhëna në këtë vendim, në të kundërtën Organi Shqyrtues i Prokurimit nga kuadri i Paneleve Shqyrtuese, ka të drejtë të kërkoj ndërmarrjen e masave disiplinore ndaj zyrtarëve përgjegjës të prokurimit.

Paneli Shqyrtues ne pajtim me nenin 117 të LPP-së vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.



Kryetar i Panelit Shqyrtues
Vedat Poterqoi

Këshillë juridike:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi ka të drejtë t'i drejtohet Gjykatës Komerciale në Prishtinë, në afat prej 30 ditësh nga data e pranimi të këtij vendimi.

Vendimi t'i dorëzohet:

- **AK - MINISTRIA E SHËNDETËSISË**
- **OE - MATKOS PHARM SH.P.K.**
- Arkivës së OSHP-së: